



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 46 / prot.

Tiranë, më 30.07.2019

VENDIM

Nr. 46, datë 30.07.2019

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR. 41, DATË
04.07.2019 "PËR MIRATIMIN E KATEGORIVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË
PERSONELIT ADMINISTRATIV TË UMT"**

Në bazë të nenit 67 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të VKM nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe nivele të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve....", i ndryshuar, të VKM nr. 717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar, të Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative, në institucionet e arsimit të lartë", në vijim të propozimit të Administratorit nr. 2061 prot., datë 18.07.2019 "Për një rregullim në Vendimin nr. 41, datë 04.07.2019", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të ndryshojë nivelin e miratuar të pagës së Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
 - 1.1 Niveli i pagës së Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, do të jetë "**II-b**".
2. Të ndryshojë nivelin e miratuar të pagës së personelit administrativ "Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme" i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe i Fakultetit të Mjekësisë.
 - 2.1. Niveli i pagës së personelit administrativ "Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme" i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe i Fakultetit të Mjekësisë do të jetë "**Klasa VI**".
3. Ngarkohen të gjitha strukturat e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë¹.

ZËVENDËS KRYETARI
Florian TOTI

¹ Tabelat bashkëlidhur të azhornuara.